



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 12/2019) dhe në përputhje me nenin 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit dhe nenit 4, nga udhëzimi për renditjen e lëndëve për veprim të KSHPK-së në bazë të denoncimeve, duke vepruar sipas denoncimit të formuar pas denoncimit nga parashtrues i njohur në vazhdimin e dytë të seancës së 50-të, të mbajtur më 23.07.2021, morri vendimin vijues:

#### VENDIM

Denoncimi i dorëzuar me datë 23.02.2021 nga //// në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në bazë të të cilit është formuar lënda me numër 12-866/1 të datës 23.02.2021, REFUZOHET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 12/19), Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk përcaktoi elemente për veprimin e tij kompetent sipas lëndës se theksuar më lartë.

Lënda me numër arkivor 12-866 e vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim- në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të saj në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

#### Arsyetim

Lënda me numër 12-866/1 të datës 23.02.2021 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga.

Në denoncim kërkohet që Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK) të ndërhyjë në Inspektoratin Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor, sepse //////////////// me kompetencat e saj //////////////// trajtimi i ///

dhe ndërhyri në mosmarrëveshjen gjyqësore /// nr. /// nga ///, ku ai kishte interes personal /// /// /// ///. Parashtruesi kërkoi nga KSHPK -ja të ndërmarrë veprime të menjëhershme brenda kompetencës së saj ligjore, ndërsa në shtojcë dorëzoi një dëshmi.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në denoncim dhe provave të bashkangjitura, KSHPK konstaton se të njëjtat nuk i referohen dyshimit për abuzim të mundshëm të detyrës, autoritetit publik, detyrës zyrtare ose pozitës nga personi zyrtar, për arsye të realizimit të përfitimit, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndërmjetësit, për veten e tij ose për tjetër, për të cilën KSHPK është kompetente në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 12/19). Prandaj, KSHPK vlerësoi se nuk ka elemente për veprimin e saj kompetent rastin konkret dhe lënda të mbyllet dhe të arkivohet. Kjo për faktin se në përputhje me dispozitat e Ligjit të lartpërmendur, KSHPK nuk ka kompetencë për të ndërhyrë në Inspektoratin Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor, në kuptimin e dhënies së udhëzimeve dhe udhëzimeve për veprimin e tij juridik kompetent.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, KSHPK vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËROR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
Kryetar,  
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te:  
Arkivi i KSHPK-së  
Përgaditi: Mr D. D.  
Miratoi: SPD, Anëtar i KSHPK-së